

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                    |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Lula ndalon lojërat e fatit online përpara zgjedhjeve presidenciale në Brazil - Euronews Albania   |
| ADRESA  | https://euronews.al/lula-ndalon-lojerat-e-fatit-online-perpara-zgjedhjeve-presidenciale-ne-brazil/ |
| BURIMI  | euronews.al                                                                                        |
| GJENDJA | online                                                                                             |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 08:35:32 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 08:30:58 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | f01c084704fab33354578c24dcd7d04c45a911318c83e6c353d0e66168d146b4 |
| TEKSTI     | ed5adbfbfe965534e3278185e3fcaa6e54ee8b1296f61ab68ca16c1c5f799817 |
| PAMJA      | f9dfcb18db2f897e4037cb08f37eb4673a20cc8f5b0de58efe043573c42b1f36 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 1934d5028383c9666506d8cb7a60dae04451f74a44b7895e7f184426e037921c                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91                                 |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1934d5028383c9666506d8cb7a60dae04451f74a44b7895e7f184426e037921c>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



## TREND

SHBA Donald Trump Inteligjenca Artificiale Gjyqi i UÇK Edi Rama

BOTA

## Lula ndalon lojërat e fatit online përpara zgjedhjeve presidenciale në Brazil

26 Shtator 2026 | 10:30

Presidenti brazilian Luiz Inacio Lula da Silva ka njoftuar ndalimin e lojërave të fatit online, vetëm disa ditë para zgjedhjeve në të cilat ai kërkon një mandat të katërt si udhëheqës i vendit.

Lula, i cili kandidon kundër djalit të ish-presidentit brazilian të burgosur Jair Bolsonaro, nënshkroi një urdhër të përkohshëm të premtën që "ndalon të gjitha bastet sportive dhe kazinotë online".

Industria e lojërave të fatit online në Brazil u legalizua në vitin 2018 dhe që atëherë është fajësuar për humbjet e përhapura të të ardhurave familjare për shkak të varësisë.

Lula e përshkroi industrinë si një "kancer" në njoftimin e tij, duke shtuar "ose e heqim tumorin, ose na vret".

Ky veprim vjen pak më shumë se një javë para raundit të parë të votimit në zgjedhjet presidenciale të Brazilit. Sondazhet e fundit e tregojnë udhëheqësin 80-vjeçar pothuajse kokë më kokë me Flavio Bolsonaro.

Masat e reja duhet të marrin miratimin e Kongresit brenda 120 ditëve që të mbeten në fuqi.

Lula pranoi se bastet online u krijuan nën administratën e ish-Presidentit Michel Temer, por se ato "u rritën pa rregullore nën menaxhimin e Bolsonaros".

"Ne nuk do të lejojmë që kompanitë e basteve të përfitojnë në kurriz të të ardhurave dhe jetës së familjeve braziliane", shtoi presidenti.

Presidenti përshkroi se si kishte dëgjuar nga familje që kishin shitur gjithçka në shtëpitë e tyre për shkak të varësisë nga bixhozi.

Shiko në:

## LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | LAJM KRYESOR

## LAJMI I FUNDIT

10:30 Dosja e 'SHISH', Bashkimi European: Kemi besim të plotë te SPAK

10:25 Kaos me pasoja serioze, agjentët e OpenAI dalin jashtë kontrollit! Implikohen faqet e qeverisë amerikane

10:25 Kishte vjedhur një automjet, gjatë arratisjes goditi 4 SHPËRNDARIAK! Vihet në pranga 30-ARTIKULLIN Vjeçari në Durrës (VIDEO)

10:19 Putin përmbys çdo pretendim: Ne nuk do të bëjmë luftë me Europën

10:10 Michael Olise barazon rekordin 68-vjeçar, 9 asistime me Francën në një vit

10:03 Shtëpia e Bardhë bllokoi CNN të udhëtojë me Air Force One

TESTIM

**Kaos me pasoja serioze, agjentët e OpenAI dalin jashtë kontrollit! Implikohen faqet e qeverisë amerikane**

Një tjetër incident serioz po ngre pikëpyetje mbi kontrollin e sistemeve më të avancuara të inteligjencës artificiale. OpenAI ka bërë të ditur se agjentët e...

10:25 | 26/09/2026

BOTA | EURONEWS ALBANIA | EVROPA

**Putin përmbys çdo pretendim: Ne nuk do të bëjmë luftë me Europën**

Moska nuk po përgatitet për veprime ushtarake kundër vendeve evropiane, tha Presidenti Vladimir Putin, duke hedhur poshtë pretendimet për një kërcënim rus si një përpjekje...

10:19 | 26/09/2026

BOTA

**Shtëpia e Bardhë bllokoi CNN të udhëtojë me Air Force One**

Shtëpia e Bardhë i ka bllokuar CNN-it udhëtimin me aeroplanin Air Force One të shtunën, duke penguar detyrat e grupit të saj të shtypit televiziv...

10:03 | 26/09/2026

TEMA

Vendi  
Rajoni  
Bota  
Video

SHËRBIME

Live  
Lajmi fundit  
Na ndiqni  
Euronews Radio  
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews  
Kushtet e përdorimit  
Politika e cookie  
Kontakttoni  
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: